



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI
KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 22.10.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it”

Drejtuar: Seancës Plenare

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 22.10.2018 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit, për vendosjen e oficerit ndërlidhës të Europol-it”.

I. Qëllimi dhe objektivi i projektligjit:

Marrëveshja që po paraqitet për ratifikim është iniciuar nga Europol-i, në kuadër të marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (EUROPOL) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, nënshkruar, më 9 dhjetor 2013, në Hagë.

Ajo synon vendosjen e oficerit ndërlidhës të Agjencisë së Bashkimit Evropian për Bashkëpunimin e Zbatimit të Ligjit (Europol) në vendin tone.

Vendosja e oficerit ndërlidhës të Europol-it në vendin tonë, konkretisht në Zyrën Kombëtare të Europol-i pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, synon të sjellë mbështetje, bashkërendim të veprimeve dhe bashkëpunim në parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe formave të tjera të krimit ndërkombëtar, si dhe lehtësim të shkëmbimit të informacionit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, Europol-it dhe shteteve anëtare të Bashkimit Evropian.

Në marrëveshje është parashikuar se oficeri ndërlidhës duhet të respektojë rregullat e sigurisë së shtetit shqiptar në masën që është e zbatueshme, në lidhje me pranimin e tij në selinë qendrore, pavarësisht nga regjimi i sigurisë së Europol-it, i zbatueshëm në veçanti për përpunimin e informacionit të Europol-it.

Marrëveshja përbëhet nga 9 nene ku konkretisht:

Neni 1 përcakton se palët bien dakord për vendosjen e një ose më shumë oficerëve ndërlidhës të Europol-it në Shqipëri.

Numri i oficerëve ndërlidhës të Europol-it do të dakordësohet paraprakisht ndërmjet palëve.

Neni 2 përcakton detyrat e oficerit ndërlidhës.

Neni 3 përcakton statusin e oficerit ndërlidhës, ku parashikohet se Shqipëria, brenda territorit të saj, do t'i japë zyrtarit ndërlidhës të Europol-it të njëjtat privilegje dhe imunitete si ato të akorduara nga Shqipëria për shtetet anëtare, me gradë të krahasueshme të stafit të misioneve diplomatike të vendosura në Shqipëri.

Neni 4 përcakton metodat e punës, ku parashikohet se gjatë shkëmbimit të informacionit oficeri ndërlidhës i Europol-it do të komunikojë me pikat kombëtare të kontaktit dhe me autoritetet kombëtare kompetente, siç është përcaktuar në marrëveshje ose në ndonjë entitet tjetër specifik brenda Shqipërisë, i dedikuar për këtë qëllim.

Neni 5 parashikon çështjet administrative për vendosjen e zyrës së oficerit ndërlidhës në Shqipëri, si dhe parashikohet përjashtimi nga të gjitha detyrimet doganore, ndalimet dhe kufizimet në importin e eksportin në lidhje me mallrat për përdorim zyrtar.

Neni 6 përcakton mënyrën për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe përgjegjësi në rast konflikti.

Neni 7 përcakton modalitetet për ndryshimet që mund t'i bëhen marrëveshjes.

Neni 8 përcakton modalitetet për përfundimin e marrëveshjes nga palët.

Neni 9 përcakton modalitetet për hyrjen në fuqi të marrëveshjes..

Shpenzimet që rrjedhin nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje do të mbulohen nga programi buxhator i Policisë së Shtetit.

II. KONKLUSIONE

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshjeje dhe përfitimeve të shumta që sjell për shtetin shqiptar, me shumicën e anëtarëve miraton projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi si dhe shprehet dakord për kalimin e këtij pr/ligji në seancë plenare.

Relator

Kryetar

Xhemal Qefalia

Ermonela (Felaj) VALIKAJ

